

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit "I. T. "me seli në Prishtinë,të cilin e përfaqësoj sipas autorizimit me shkrim I. D. avokat nga P., ndaj të të paditurës NTSH 3 B. me seli në P.,të cilin e përfaqësoj avokati D. G. nga P.,për shkak të mospërmbushjes së kontratës dhe kompensimit të dëmit,vlera e kontestit prej 197.754,50 euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;15.12.2014,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare nga palët ndërgjyqëse me datën;05.01.2015 merr këtë:

### A K T G J Y K I M

I.Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit "I. T."me seli në P.,me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura NTSH 3 B. me seli në P. që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të fitimit të humbur t ia paguaj shumën prej 197.754,50 euro,me kamatë ligjore 3.5% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë;25.07.2012 e deri në pagesën definitive,si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore,në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.Secila palë do ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

### A r s y e t i m

Paditësi "I. T. "me seli në P.,ka parashtruar pranë kësaj gjykate padi me datën 25.07.2012 ndaj palës së paditur N.T.SH 3 B. me seli në P.,duke kërkuar që e paditura t'ia paguaj kompenzimin e dëmit për shkak të fitimit të humbur në shumën e përgjithshme prej;440.750,00 euro,me kamatë ligjore 3.5% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë;25.07.2012 e deri në pagesën definitive të borxhit,njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka mbajtur seancat në të cilën i autorizuari i paditësit ka precizuar kërkesëpadinë e tij në shumën prej;197.754,50 euro dhe atë duke u bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës njëherit ka deklaruar se me datën 17.05.2012 me të paditurën janë takuar në zyret e paditësit me ç;rast pas bisedave të zhvilluara paraprakisht kishin arritur marrëveshje për porosinë e pasijeve telefonike,mirëpo me datën;19.06.2012 i padituri e njofton paditësin me shkresë elektronike se lidhur me marrëveshjen e datës;17.05.2012 për shkak të gabimeve në kalkulim nuk mund të përmbushet oferta,dhe mbi këtë bazë paditësi shton se në mes palëve ndërgjyqëse është arritur lidhja e kontratës në kuptim të nenit 26 të LMD-së,dhe njëherit i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurit ka deklaruar si në përgjigje në padi dhe në seancat e mbajtura se nuk është kontestuese fakti se i padituri ka pasur negociata në mënyrë bona fides me paditësin për të arritur marrëveshje mirëpo asnjëherë nuk është arritur pëlqimi lidhur me aprovimin e ofertës nga ana e të paditurit,sa i përket çmimit të mallit të ofruar,kushtet e pagesës për mallin e dorëzuar,afatet dhe mënyrën e pagesës së mallit të dorëzuar,detyrimet e të paditurit lidhur me garancionet për mallin e ofruar etj.për të gjitha këto është dashur të pajtohen me ofertën e shumës si dhe çështje tjera si parashihen me dispozitat e LMD-së me rastin e lidhjes së kontratës mbi blerjen e mallit, dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike ka administruar këto prova si në vijim:analiza e ofertës e datës 14.05.2012,email-at e datës;17.05.2012 dhe 16.05.2012,specifikacioni i datës;31.05.2012,porosia e datës;31.05.2012 nga ana e paditësit,emaili i datës 19.06.2012,shkresa e paditësit e datës;21.06.2012,ekspertiza e ekspertit A. B. e datës 05.04.2013,si dhe oferta e datës;09.05.2012.

Pas shqyrtimit të detajuar të provave të administruara,shkresave të lëndës,thënieve të palëve, duke e bërë vlerësimin e secilës provë vec e vec dhe të gjithave së bashku,në vështrim të nenit 8 të LPK-së,gjykata gjeti se;në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se palët kanë qenë në bisedime për të arritur marrëveshje lidhur me porositjen e pajisjeve telefonike por kontestuese ishte fakti se e paditura pretendon se nuk është arritur pëlqim i plotë për aprovimin e ofertës dhe se asnjëherë nuk është arritur deri te lidhja dhe nënshkrimi i kontratës.

Gjykata nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të aktuaristikës A.B. ka konstatuar se marrëveshja apo kontrata për furnizim me pajisje telefonike nuk ka ekzistuar,pasiqë nuk ka patur elementet esenciale për lidhjen e kontratës,dhënja e avansit,garancioni në ndonjë bankë komerciale,afati e liferimit të mallit dhe se në mungesë të provave të cilat nuk janë zyrtare, nuk mund të legjitimohen as detyrimet ndërmjet palëve.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara gjykata gjeti se nuk është arritur marrëveshja-kontrata,sepse nga shkresat elektronike me të cilën e mbështet paditësi kërkesëpadinë e tij nuk kanë përmbajtje të plotë dhe se nuk posedojnë kuartësin e marrëveshjes përfundimtare,me të cilën në rastin konkret do të konsiderohet se janë plotësuar kushtet esenciale të kontratës sipas nenin 26 të LMD-së,dhe se kjo marrëveshje do të duhej të ishte e pranuar nga të dy palët në procedure.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitën nenit 39 të LMD-së e cila në mënyrë shprehimore ka paraparë se "Oferta quhet e pranuar kur ofertuesi e merrë deklaratën e të ofertuarit se e pranon ofertën, oferta quhet e pranuar edhe atëherë kur ofertuesi e dërgon sendin ose e paguan çmimin, si dhe kur bën ndonjë veprim tjetër i cili në bazë të ofertës, praktikës së vërtetuar midis palëve të interesuara dhe zakoneve, mund të konsiderohet si deklaratë mbi pranimin. Pranimi mund të revokohet nëse ofertuesi e merr deklaratën mbi revokimin përpara deklaratës mbi pranimet ose njëkohësisht me të, si dhe sipas dispozitës së nenit 41 të LMD-së është bazuar në faktin se kjo dispozitë në mënyrë decisive ka paraparë se "nëse i ofertuari deklaron se e pranon ofertën dhe njëkohësisht propozon që ajo diku të ndryshohet ose të plotësohet, konsiderohet se ofertën e ka refuzuar dhe se nga ana e vet i ka bërë ofertë tjetër ofertuesit të vet të mëparshëm", andaj ka vendosur që të refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata ka refuzuar propozimin e paditësit për caktimin e një eksperti tjetër financiar, sepse në kuptim të nenit 356 të LPK-së gjykata ka vlerësuar se të gjitha faktet dhe rrethanat vendimtare janë të qarta dhe të provuara me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe se nuk është e nevojshme nxerrja e ekspertizës së re.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 par. 2 të LPK-së.

Andaj, si u tha më lart Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-  
III.C.nr.320/2012, me dt;05.01.2015

Gjyqtarja  
Franciska Zhitia-Ymeri

**UDHËZIME JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.